




## Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



### PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **17.05.2018**, me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të përshëndes, Nënkyetarin Fatmir Iska, delegatët e pranishëm në këtë seancë të KPF-së, monitoruesit e KFORIT, OSBE-së, drejtoret e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.

### REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar,
2. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore,
3. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme në fshatin Ratkoc,
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për Drejtorin për Punë Inspektuese,
5. Informatë rreth sigurisë në shkollat e Komunës së Rahovecit,
6. Informatë rreth ecurisë së hartimit të PZHK-së,
7. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Stone Castle),
8. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale.
9. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për Caktimin e Lokacionit për Vendosjen e Trafostacionit dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale,
10. Të ndryshme.

**Kryesuesi** - A ka dikush të shtoj diçka sa i përket rendit të ditës.

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari Kryesues, ne para vete kemi ma shumë material se sa pikë të rendit të ditës. Prandaj propozoj që për pikën e 8 të rendit të ditës të i cekni të gjitha propozimet veç e veç së paku të ceken në rend të ditës zona kadastrale. Po ashtu ju sugjeroj që herrave të tjera çdo propozim ta ketë pikën e vet të rendit të ditës.

**Florije Boshnjaku**- Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, unë kam një propozim nëse pajtohen kolegët që pikë e katërt e rendit të ditës, shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për drejtorin për punë inspektuese mos ta shqyrtojmë sot, pasi që siç edhe mora një informatë jozyrtare nuk është prezent as auditori i brendshëm këtu , por kjo pikë të përcillet për në mbledhjen e radhës të kuvendit komunal, pasi që nëse auditori nuk është prezent nuk e di sa mund ta diskutojmë këtë problematikë.

**Rasim Fazliu-** Shikoni, ju na keni servuar këtë pikë të rendit të ditës dhe unë nuk e shoh të arsyeshme që tash të hiqet, pastaj qeveria komunale është prezent dhe nuk është e nevojshme që auditori të jetë patjetër këtu, mund të diskutojmë e kur të arrijmë tek diskutimi atëherë kam fjalë tjera çka të flas.

**Dervish Çadraku-** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, meqë nuk e aprovuan ende rendin e ditës unë kam vërejtje për materialin e sotëm që na ka ardhur, është një praktikë jo e mirë që po ndodh, nuk është hera e parë që materiali vjen brenda kohës kur ne mbajmë mbledhjen, është fjala për atë propozimin në Bërrnjakë, unë për vete nuk kam asnjë të dhënë as njoħuri çka do të ndodhë atje në kuptimin e asaj se nuk kemi kohë njëfarë mënyre as ta lexojmë ose studiojmë të shohim sa është e arsyeshme, edhe kemi shumë arsyé që ta shtyjmë këtë mbledhje deri sa të na vjen ky material i plotë, të shikojmë se a ka të drejtë, a është e përfshirë në planin urbanistik ose jo, më duket që është caktuar edhe firma e cila do të mirret me këtë punë, unë nuk kam njoħuri se a hyn në këtë plan apo nuk hyn në fund të fundit duhet të na sillet materiali me dëshmi që është e futur në këtë plan andaj unë propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër.

**Kryesuesi- Ftojme z. Isak Hoti nga zyra ligjore që të na jepe mje sqarim rreth kësaj pike:**

**Isak Hoti-** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Dervish faji ka qenë i imi, e marr si barrë, materiali është në përputhje me ligjin rreth kësaj pike na ka vonuar vetëm kjo çështje pra të konsultohemi drejtë me ligjin, unë kam punuar edhe në shtëpi vetëm që të përfundojë sa më shpejtë këtë materiali në mënyrë që materiali të sillet sot në kuvend, nuk ka asgjë tjetër pos që ajo pjesë në Bërrnjakë nuk është fare e paraparë me planin zhvillimor komunal të vitit 2013, si rezultat i kësaj ligji për tokat bujqësore kërkon që të mirret vendim në kuvend sepse është e drejtë, edhe nen 41.1 e keni edhe në preambulë e jep të drejtën që kuvendi komunal të miratojë vendimin dhe të shkohet për shqyrtim në Ministrinë e Bujqësië Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe pastaj ata vendosin nëse e japid pëlqimin për ndërrim destinim apo nuk na japid pëlqimin për ndërrim destinim të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, kërkesa është e Stone Castle përkatësisht z. Rrustem Geci si pronar, edhe ai kërkon që të bëhet ndërrim destinimi i kësaj parcele për ndërtimin e një kompleksi turistik e keni edhe një arsyetim, është një qendër rezidenciale hotelierike që unë besoj edhe pse nuk jam unë ai që mundet me arsyetu por që në bazën ligjore kjo më ka vonuar për të sjellë materialin në kohë unë kërkoi falje edhe njëherë për të gjith[ , edhe paraprakisht para se të hyjmë në mbledhje të tregova Dervish që faji është personalisht i imi.

**Kryesuesi- Faleminderit z. Hoti, atëherë këtu u ngritën disa dilema rreth pikës së katër nga znj. Boshnjaku që shqyrtimi i raportit të auditimit të shkojë drejtë për në kuvend, nga z. Fazliu që të jetë pjesë e kësaj mbledhjeje dhe kërkesa e z. Çadraku që pika rreth Stone Castle të shtyhet për mbledhjen tjetër, unë mendoj që të vazhdohet me pikat e rendit të ditës kështu siç i kemi dhe të procedojmë më tutje.**

**Nënkryetari-** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në diskutimin që e pat z. Fazliu unë pajtohem plotësisht në formulimin e pikës së rendit të ditës por pasi që janë shumë propozime ne e kemi emërtuar si pikë të rendit të ditës shqyrtimi i Propozim Vendimit për dhënen në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale pasi që kemi 4 propozime nëse nuk gaboj, nëse pajtoheni në seancën e kuvendit komunal mund të përfshijmë 4 propozime veç se renditja del në dy faqe, e formulojmë pikën e rendit të ditës në bazë të propozimeve ashtu siç janë, ndërsa sa i përket propozimeve unë nuk kisha thënë që të qitet në propozim a të hiqet një pikë e rendit të ditës apo jo mirëpo edhe unë e shoh të arsyeshme pavarësisht që nuk është prezent përfaqësuesi i auditimit të brendshëm , mund të diskutohet pasi që është dhe drejtori këtu edhe ai nuk është shumë kompetent të diskutojë meqenëse e kap një periudhë të vitit 2017 dhe 2018 por krejt çka mundet drejtori për punë inspektuese do të jep sqarime pasi që ne jemi këtu për punën që e bëjmë ne , ju jeni ajo llupa në mënyrë që ne të dalim sa më transparent para qytetarëve.

**Kryesuesi-** E qesim në votim rendin e ditës, konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar rendi i ditës, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës

### **1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.**

A ka dikush të shtojë diçka rreth procesverbalit nëse jo e qesim në votim Procesverbalin nga Mbledhja e Kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e parë e rendit të ditës, kalojmë në pikën e dyte të rendit të ditës

### **2. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolomi i objekteve ndërtimore.**

Për këtë pikë ftoj drejtorin e shërbimeve publike z.Përparim Krasniqi.

**Përparim Krasniqi-** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne kemi vendosur që në seancën e Kuvendit Komunal të vendosim një pikë për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, ky lokacion është në pajtueshmëri me ligjin për mbeturina me numër 04B60 dhe udhëzimi administrativ 01/2017 për dhënen e lejes mjedisore komunale dhe udhëzimin administrativ 07/15 për menaxhimin e mbeturinave dhe ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, lokacioni gjendet diku në periferi të Komunës së Rahovecit në pjesën veriore zonën kadastrale, ju si material shështë e keni edhe një pëllqim mjedisor nga eksperti i DEMOS-it të bërë para një viti, mos të hymë tanë në detale se çka e specifikon leja mjedisore, mënoj se është në të mirën e qytetarëve që kjo pikë të kaloj sepse ene po kemi vazhdimisht probleme të vazhdueshme me mbeturinat inerte si Komunë e Rahovecit. Ne nga data 02 Maj 2018, kemi filluar largimin e mbeturinave inerte ilegale në të gjithë Komunën e Rahovecit, të evidentuara janë rreth 48 deponi ilegale deri më tanë pastruar 20 prej tyre. Kjo iniciativë për pastrimin e deponive është e mirë sepse mundemi ne si Komunë të përfitojmë grande qeveritare nga Ministria e Mjedisit nëse e zbatojmë planin për eliminimin e mbeturinave inerte. E keni në projektor të paraqitur zonën se ku do të jetë mbeturina inerte prandaj kërkoi nga ju që ta mbështetni këtë pikë që të shkoj në Kuvend për tu aprovuar.

**Kryesuesi – Ju faleminderit, e hapim debatin sa i përket kësaj pike.**

**Rasim Fazliu –** Ne këtë vendim e kemi parë në vitin 2017, ku kemi biseduar për këtë lokacion, tanë çka keni menduar ju për më tutje për këtë, a ka diçka shështë ose të re rreth kësaj, a do të jepet me koncession apo vetë Komuna do e menaxhojë, pastaj sa do të jetë shuma e investimeve etj. përndryshe nëse e marrim si tërësi unë pajtohem me këtë propozim, është shumë me vend dhe plotësisht pajtohem që Komuna e Rahovecit ta ketë një vend ku do të kenë mundësi qytetarët të i hedhin mbeturinat inerte. Sa i përket këtij raporti për leje mjedisore e kam lexuar me shumë vëmendje, por ajo që më ka lënë përshtypje ky raport ma shumë ishte gjeneral sepse ma shumë kishte të bënte me territoret e Kosovës, si për florën, faunën në etj, kurse shumë pak për vendin ku ne mendojmë me e destinuar për mbeturina inerte. Mendoj se ky raport i ministritë së mjedisit është dashur më tepër të bazohet në lokacionin që jemi ne sot duke diskutuar.

**Florije Boshnjaku –** Falenderoj Kryetarin e Komunës dhe drejtoren që na kanë sjellë këtë propozim vendim i cili është shumë me vend. Desha të ndërlidhem me diskutimin e z. Rasim Fazliut, i nderuar këtu nuk është data e vendimit por numri i protokollit dhe data e statutit të Komunës kur është miratuar. Sa i përket deponitë ilegale që i keni pastruar, ju përgëzoj dhe ju falënderoj për punën që jeni duke bërë sepse me të vërtet Komuna ka nevojë sepse ky është interes i përgjithshëm, shpresoj se shumë shpejtë edhe ato deponitë e mbetura do i largoni. Shpresojmë se shumë shpejtë të caktohet ky lokacion sepse është interes i qytetarëve, jam pro këtij propozim vendimi, shpresoj se ky vendim do të gjejë zbatim dhe mos të mbetet vetëm në letër.

**Fahrije Lushi Morina –** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, konsideroj se ky projekt është i mirëseardhur sepse çdo projekt ku përfitojnë qytetarët nuk do koment, pyetja ime për ekzekutivin është: A do të dëmtohen tokat punuese të cilat gjenden afér kësaj deponie, pra nëse është e dobishme në një anë a e keni analizuar se mos është e dëmshme për ato toka punuese të cilat gjinden afér kësaj deponie.

**Fehmi Cena –** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha një sqarim për vete besoj se do i ndihmojë edhe të tjerëve që janë prezent, edhe pse jam duke e parë skicën dhe shumë mirë e njoh atë teren megjithatë saktësisht nuk po mundem me ditë se ku gjendet ky vend, ne e dimë se ekziston një deponi inerte skaj rrugës duke shkuar për në Prishtinë, pastaj ajo që më intereson mua është se në atë pjesë a ka vreshta privat, nëse po a është biseduar me ata fermerë. Sa e di unë në atë pjesë është edhe lumi rimnik, a do të ketë ndotje ky lumë sepse siç e dimë ne ky lumë është arteria kryesore e tokës së asaj ane. Pyetje tjetër është se kush do ta menaxhoj këtë deponi nëse bëhet, a do të bëhet konform standardeve për mbrojtje të ambientit, pastaj kjo deponi a është për gjithë komunën e Rahovecit apo vetëm për qytetin e Rahovecit sepse sa për mendimin time sipërfaqja prej 3.5 hektar nuk është edhe aq e madhe për ti grumbulluar të gjitha mbeturinat e komunës. A ka afatizim dhe nëse kjo deponi mbushet mos vazhdon pastaj të i tejkalojnë kufijtë, sepse atëherë sigurisht do të ketë pasoja. Është mirë të shikohen edhe ato deponi që janë në regjione të tjera të Komunës sepse të gjithë mundohemi që të kemi sa më të pastër ambientin ku jetojmë, por ne duhet që të mendojmë edhe për qytetin e mos të bëhet tanë që të gjitha mbeturinat e fshatrave t komunës sonë të hedhen në periferi të qytetit, pastaj qyteti të merë barrën e ndotje. Kam edhe disa vërejtje rreth terminologjisë, këtu ceket si pjesë e Senjane ose ravne shume, mendoj se duhet që të ketë edhe terminë në gjuhën shqipe si rrafsh malet ose malet e rrafshëta, pastaj nuk është Sernjane por Sejana është vendbanim i lashtë Ilir. Të shikohet po ashtu edhe pjesa

arkeologjike mos ka gjurmë të qytetit të vjetër sepse përmendet një kishë e lashtë në ato vende, prandaj të shikohet mos të mbulohen këto elemente që janë të rëndësisë arkeologjike.

**Dervish Çadraku** – Është shumë me rëndësi se çfarë do të ndodhë me ujërat e rrjedhshëm që janë në atë pjesë, nëse nuk ka ujëra burimorë ka ujëra që rrjedhin pas të resurave dhe pastaj mundet të ketë pasoja jo të mira për ambientin, operatori ende nuk është përzgjedhur, prandaj është mirë që të theksohet këtu që duhet të bëhet një plan, pastaj me këtë plan paraprakisht të njoftohet kuvendi se a është në konditat e këtij plani dhe operatori a ju është përbajte planit apo jo sepse shumë herë ka ndodhur që është aprovuar një venim në kuvend por nuk ka shkuar pastaj çuna ashtu siç është vendosur në kuvend, prandaj mendoj se kur ta bëjë operatori këtë plan të jetë i njoftuar edhe kuvendi dhe me ketë kushte e kisha votuar këtë pikë edhe pse është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme por është mirë që të informohen se si është duke u implementuar ky plan. Mendimi tjetër për këtë pikë është ashtu siç e tha edhe kolegu z. Fehmi Cena, ndoshta kjo deponi është e pamjaftueshme për komplet territorin e Komunës së Rahovecit, prandaj është mirë që ti kemi edhe dy deponi të tjera, në pjesën andej gradishit dhe këndej gradishit sepse nëse mbeturinat vetëm me këtë deponi kjo shumë shpejtë do të mbushet dhe mos të krijohet ajo përshtypje se të gjitha mbeturinat i ke dërguar në Rahovec, mendoj se ka vende edhe nga ana e fshatrave tanë për deponi inerte, sepse janë lokalitete bukur të mëdha, nëse dele dh shikon tek pjesa andej gradoshit do të çuditesh se sa mbeturina inerte gjenden rrugës, kurse inspektorati asgjë nuk bënë, është mirë që edhe inspektorati të mirët pak me këto punë, prandaj edhe një herë po e them se duhet që të përfaqësojmë të gjitha interesat e qytetarëve në gjithë territorin e Komunës së Rahovecit.

**Përparim Krasniqi** – Do i përgjigjem ma radhë çdo njërit, i nderuari z. Rasim Fazliu sa për informatë nuk ka vendim për këtë lokacion, ka vetëm pëlqim mjedisor nga zyrtari i DEMOSIT i cili e ka bërë ekspertizën pastaj e ka dorëzuar në komunë, por nuk janë mara hapat e tjera për vendosjen e lokacionit me vendim. Po ju njoftojë se deri në 60 mijë banorë sipas ligjit, kuvendi i komunës vendos për lokacionin e mbeturinave inerte, kurse mbi 60 mijë banorë vendos ministria e mjedisit. Znj. Fahrije Lushi pyeti mos dëmtohen tokat bujqësore, e nderuar po ju njoftoj se kjo nuk është në pjesën e lumi rimnik, ky lokacion është përball KFORIT, aty është kjo gropë e madhe e cila nuk ka as ujëra e as vreshta, pra i plotëson kriteret për deponi për mbeturina inerte. Po ju njoftoj se mbeturinat inerte do të trajtohen në dy mënyra, ato që janë nga demolimet e shtëpive do të ndahen veç, kurse dheu do të ndahet veç, në momentin që mbushet gropë me mbeturina ngurta atëherë i hedhet asaj pjesë dheu në mënyrë që në të ardhmen të jetë tokë pjellore. Komuna ka të drejtë të jepe me ankand publikë atë deponi ose nëse ka mjete buxhetore në planifikimet e ardhshme, komuna mundet me e menaxhoj deponin, por aty duhet që të plotësohen disa kushte, duhet që të rrethohet, të vendoset rryma, uji, pastaj rruga duhet që të rregullohet, pastaj duhet që të punësohet një person përgjegjës i cili do i trajtoj mbeturinat. Pastaj sa i përket termit në kadastër atë ne nuk mundemi të i ndryshojmë, janë emërtimet e vjetra të cilat ne nuk mundemi me ndërhy dhe me i ndyshu në gjuhën shqipe. Është mirë të lexohet edhe rapporti i ekspertit të Demosit sepse aty ai ka sqaruar se nuk ka ujëra të rrjedhshëm dhe nuk e pengojnë hedhjen e mbeturinave inerte në atë zonë. Po ashtu z. Dervish Çadraku pyeti se a do të ndërtohen edhe deponi të tjera, i nderuar ne duhet që të kemi hapësira dhe ato hapësira duhet që ti plotësojnë kriteret, hapësirë që jemi duke biseduar i ka plotësuar kriteret, po ashtu edhe një informatë deponia ku do të vendosen mbeturinat inerte është me sipërfaqe prej 1.5 hektar, kurse e gjithë hapësira është 3 hektar. Sa i përket deponive në vende të tjera të Komunës duhet të shikohen lokacionet ku kanë hapësirë, ne do të bëjmë një analizë me ekspertët e mjedisit dhe të shikohet se a i plotëson kushtet për të bërë deponi inerte. Kurse në vendin ku janë gjuajtur deri më tanë mbeturinat inerte rrugës për Malishevë, ajo nuk është deponi legale por ilegale, ne e kemi në plan në muajt në vazhdim që ti rrethojmë dy anët e rrugës në mënyrë që mos të hedhen më në atë vend mbeturinat.

**Nënkryetari** – Siç e dini ai lokacion që e kemi trajtuar ne me 22.04.2018 në ditën e tokës është ku kemi bërë pastrimin e atij ambienti, komuna para dy javë ka angazhuar dy roje të fushës dhe të mjedisit dhe besoj se tanë sadopak është duke u parë rezultati sepse m nuk bëhet hedhja e mbeturinave. Sa i takon lokacionit të kësaj deponia që jemi tanë duke e shqyrtuar, besoj se ajo mundet të shihet dikur më vonë kur të bëhet rrafshimi i këtij tereni sepse aty do të duhet të rregullohet infrastruktura e rrugës, ujit dhe rrymës. Menaxhimi i lokacionit për momentin është ky lloj i menaxhimit me angazhim të këtyre dy rojeve deri sa të bëhet një zgjidhje tjetër deri sa ti jepet dikujt me koncesion, Pastaj sa i takon terminologjisë që e përmendi z. Cena, ne i nderuar nuk mundemi të intervenojmë në fletë posduse se sepse enë çdo vendim shënohet se bazohet në fletën posduse,

ne nuk kemi se çka ti bëjmë këtyre institucioneve qendrore që nuk i marrin për bazë këto që ti rregullojnë këto emërtime, pra për deri sa është kështu ne duhet patjetër të bazohemi në fletë poseduese. Edhe unë jam i pajtimit me z. Cena që të shkruhet në gjuhen shqipe, por nëse bëhet kjo atëherë nuk do të përputhet vendimi me fletën poseduese, pra deri sa të rregullohet kjo në qendër ne duhet që të vazhdojmë kështu.

**Fehmi Cena** – Nuk jam kundër që të jetë ky lokacion për deponi inerte, por mendoj se në të njëjtën kohë të punojë komuna që ti ketë më shumë se një deponi inerte, vetë bartja e mbeturinave nga një lokacion i largët ju sjellë probleme, pra së paku komuna jonë duhet që ti ketë 2-3 deponi. Sa i përket ndotjes së lumiit riminiq uroj që edhe kjo por edhe deponit e tjera në të ardhmen të bëhen konform standardeve sepse ndotja mund të bëhet edhe nga reshjet atmosferike. Deponia që ka qen deri më tanë të cilën drejtori e quajti ilegale, është mirë që të ndërpriten hedhjet e mbeturinave andej. Sa i përket terminologjisë e kuptoj që nuk është kompetencë e disa drejtorive, por është kompetencë e komunës. Terminet dihet se si janë vendos në të kaluarën, nuk jam unë që të ndryshohen menjëherë sot ose në mbledhjen e ardhshme, por kishte me qen mirë që në të ardhmen të ndodhin ndryshimet është mirë që të miret një iniciativë nga komuna sepse ne i dëmë terminologjinë, niveli qendrorë nuk mundet me i ditë. Të gjitha janë në gjuhen serbe, ne i përdorim edhe shqip por nuk i shkruajmë në dokumentacione, ne si komunë duhet që të marrim masa që në të ardhmen të shkruhen në gjuhen shqipe. Të nderuar sa herë që do i shohë vetëm në një gjuhë terminët do të reagoj çdoherë.

**Nënkyetari** – i nderuar z. Cena e thash edhe më parë që ju e keni plotësisht të drejtë dhe nuk e besoj se dikush është kundër kësaj, por ajo që duhet të merë iniciativë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, pastaj agjensioni kadastral i cili punën nën ombrellën e kësaj ministrie, e tek pastaj në funde vjen komuna. Ne mundemi që ti dërgojmë kërkësë agjensionit kadastral dhe ministrisë, por besoj se kjo çështje duhet që të rregullohet në nivel republike. Në mandatin e kaluar kur kam qen Dreitor i Gjeodezisë dhe Kadastrës e kam dërguar një kërkësë në ministri ku e kam angazhuar edhe prof.. Sabajdin Cena, por ajo iniciativë ka ra në veshë të shurdhër. Sa i takon cakttimeve të deponive tjera në komunën tonë, ne do të vazhdojmë sepse kjo që tani jemi duke diskutuar është vetëm si pikë fillestare, është shumë normale që nuk bënë një banorë i fshatit Mrasor të vije në Rahovec të i hedhë mbeturinat e ngurta. Ne i kemi dërguar disa kërkesa Ministrisë së Mjedisit presim përgjigje nga ministria dhe të shohim se çka mundet të i ndihmojë Komunës së Rahovcit.

**Florije Boshnjaku** - Të gjitha atë që desha ti them e tha nënkyetari, pajtohem edhe me atë që e tha z. Cena, por siç e tha edhe nënkyetari në këtë çështje e kemi ngritur, mirëpo kishte me qen mirë që këto shqetësimë të ngritet nga përsaqësuesit tanë që janë në Asociacionin e Komunave të Kosovës.

**Kryesuesi** – E qes në votim Propozim Vendimin për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolomi i objekteve ndërtimore. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovar pika e dytë (2) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

### 3. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme në fshatin Ratkoc.

**Afrim Oruqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në bazë të dispozitave të nenit 11 të ligjit 04L/144 është vu në lëvizje me kërkësë të zyrës së Kryetarit që të i zhvillojmë procedurat në lidhje me zonën kadatsrale në fshatin Ratkoc, në vendin e quajtur Selo, pra prapë terminologji serbe. Sa i përket kësaj shumë mirë e shpjegoi nënkyetari, ne shumë shpejtë e kemi pas një raste me shkollën fillore “Bekim Sylka”, më herët ka qen “Mihal Grameno” ne kemi provuar që të ndryshojmë dhe kemi nxjerrë një fletë poseduese të këtij vendi ku është kjo shkollë fillore fatkeqësisht na del që është Vuka Raxhiq, ne kmei provuar që ta ndryshojmë por nuk kemi mundur sepse kjo është përgjegjësi direkët e agjensionit kadastral të Kosovës dhe e Ministrisë së Mjedisit. Sa i përket pikës që ishim duke diskutuar, këtu kemi të bëjmë me një pronë që është në zonën kadastrale në fshatin Ratkoc. Ministria e Kulturës ka kontraktuar një kompani për ti zhvilluar projektet përfushën e sportit në Rahovec dhe njëkohësisht edhe përfushën e sportit në Ratkoc, ata kanë kontaktuar me zyrtar; kompetent të Komunës dhe ju kemi ofruar lokacion, por sipas projektuesve ka qen e paraparë që minimal me i pas dy hektar në dispozicion pronë shtetërore, në mënyrë që të munden me e projektuar një fushë të sportit. Vendi ku aktualisht gjendet fusha e sportit në Ratkoc, me nr. 2412-2 nuk i plotëson kushtet e nevojshme përfillimin e projektimit të stadiumit, ne të ngjitura me këtë parcelë të stadiumit i kemi katër parcela të cilat fik=gurojnë pronë shtetërore e Kosovës, e ato janë me nr. 1753-2, 1753-4, 1753-3 duke vazhduar përskaj rrugës në kthim mbrapa në fshatin Ratkoc. Të gjitha këto parcela së bashku bëjnë 1.2 hektar, në pamundësi për me i zhvillu punimet neve gjerësia na ka penguar, ne

kemi kontaktuar me pronarë të cilët e kanë parcelën e ngjitur me stadiumin e cila e ka nr.2412-1, në fletën poseduase tek ne figurojnë 10 pronar, por bashkëpronar të kësaj parcele realisht janë 3 persona dhe këta 3 pronarë kanë autorizuar me autorizim si përfaqësues të tyre avokatin z. Bajram Morina. Ne si Drejtori kemi qen në teren ku e kemi bërë incizimin e terrenit, ku kemi bërë një dakordim me përfaqësuesin z. Bajram Morinën për këmbim të pronës komunale me pronë private në interes të përgjithshëm komunal. Prandaj në parim nëse na jepet drita e gjelbër nga ju sot për këmbim të kësaj prone komunale me private 1 për 1, sipas projektuesve neve na janë dashur së paku edhe 25 ari, në drejtë të zgjerimit të parcelës, prandaj ne e kemi paraparë që këtë parcelë kur ta zgjerojmë në drejtë të pronës private me e këmby ngjitet me pronën shtetërore që është parcelë me nr. 1753-4. Pastaj duhet të vlerësohet nga një komision i ngritur nga Ministritë së Financave për vlerësim të pronës, kërkoi nga ju të nderuar kuvendarë pasi është në interes të përgjithshëm ta e përkrahni këtë propozim vendim në mënyrë që të vazhdohet me procedurat e mëtutjeshme.

**Rasim Fazliu** – Qëllimi i këtij propozim vendimi veç dihet, është për krijimin e kushteve optimale për ndërtimin e fushës së sportit, ne jemi pro kësaj në mënyrë që rrinia janë të ketë mundësi të i zhvillojë lojerat. Drejtori e ceku se kanë biseduar me pronarë që i kanë afër parcelat dhe sipas tije ata e paskan dhënë pëlqimin, por pyetje ime për Drejtorin është: i nderuari drejtor a keni ndonjë pëlqim me shkrim nga ana e këtyre pronarëve apo vetë gojarisht keni biseduar, mendoj se pëlqimi me shkrim është shumë më i vlefshëm. Përndryshe nëse këta pronarë janë të pajtimit për këmbim të pronës private me atë shtetërore ne jemi pro këtij propozim vendimi.

**Dervish Çadraku** – Mendoj se patjetër duhet që të ketë një pëlqim me shkrim sepse mundet të ndodhin gjërat e ndryshme dhe pastaj të kthehem i pikën zero, por ajo që më intereson mua a janë të njëjtat kategoritë tokave sepse ka shumë me rëndësi se a janë të të njëjtës kategori.

**Fahrije Lushi Morina** – Pasi këtu janë të vendosura disa të dhëna rreth pikës përkatëse, kërkoi që së pari këmbimi i këtyre pronave të bëhet publik, pastaj arsyetimin e kësaj pike se si e shohin të arsyeshëm banorët, pra pasi të bëhet publike kjo marrëveshje duhet që të shikohet se a ka pajtueshmëri nga të gjithë banorët e fshatit edhe pse një gjë e tillë doemos duhet përkrahur por pasi kërkesa është për shkëmbim të parcelave nga pronë private në pronë publike kishte me qen mirë që të kemi ma shumë informata.

**Afrim Oruqi** – Ne jemi takuar dy herë me pronarë legjitim të kësaj parcele, pronarët siç e ceka më parë e kanë autorizuar një avokat por paraprakisht pëlqim me shkrim nuk kemi pasur të drejtë të bëjmë përfaktin se ju jeni ata që na lejoni neve që ti zhvillojmë procedurat e tjera ligjore, ne nuk guxojmë të ndërmarrim asnjë hapë deri sa nuk marrim dritën e gjelbër nga ju. Kurse nëse pronarët heqin dorë nga shkëmbimi i parcelave atëherë e gjithë procedura bie poshtë. Sa i përket pyetjes që ishte rreth kategorisë së tokave, në material e keni skicën dhe mundeni të shihni se pjesa e parë skaj rrugës është pronë e komunës, kurse pjesa e dytë është pronë private, gjerësia e fushës aktuale është 80 metra, kurse neve minimum na duhen 120 metra që të mundemi me i zhvillu punimet, pronarët kanë kërkuar që të jetë këmbimi 2 me 1 në favor të tyre sepse toka e tyre është më e mirë, por ideja ka qen pse është në interes të fshatit kemi arritur marrëveshje në parim që të bëhet këmbimi 1 me 1, pra 25 ari me 25 ari. Po ashtu sa i përket vlerës së tokës është një komision i ngritur në ministri siç e ceka i cili e vlerëson, por ky komision vije në lëvizje kur ne i kalojmë të gjitha këto procedura, pra tanë ne jemi në fazat e para.

**Florida Bajraktari** – Përshtendetje për të gjithë, sa i përket kësaj që është diskutuar deri më tanë, ne nuk këruam nga drejtori që të lidhë kontratë menjëherë, por vetëm një pëlqim, ne jemi të pajtimit që të bëhet ky këmbim i pronave.

**Nënkryetari** – I nderuari z. Dervish Çadraku kategoria e tokës është e klasit të dytë dhe kur janë parcelat e bashkuara klasi është i njëjtë dhe komuna nuk mundet me ndërhy që ta ndryshoj klasën e tokës për këtë është kompetente ekskluzivisht agjensioni kadastral ekskluzivisht ministria e mjedisit dhe e bujqësisë. Kurse pyetje tjetër që është bërë se a pajtohen banorët e atij vendbanimi me këmbim të pronës dhe a është publik vendimi, e nderuar në momentin që është mare iniciativa është publike gjithçka, pastaj kur shpërndahet materiali për kuvend gjithçka është publike po ashtu sepse ne jemi të zgjedhur nga qytetarët. Kurse a pajtohen ata apo jo besoj se po sepse është në interes të një vendbanimi dhe zakonisht komuna nuk vepron kundra interesave të askujt, pra klub i futbollit në Ratkoc është i pajtimit, komuna e Rahovecit është e pajtimit, besoj se çdo kuvendarë do të jetë i pajtimit, kryetari i fshatit është i pajtimit dhe ajo që është shumë e rëndësishme është se janë të pajtimit edhe ata që e këmbejnë pronën private me atë shtetërore janë të pajtimit, besoj se e gjitha kjo

është në interes të ndërtimit të një stadiumi të futbollit i cili ndoshta do të jetë i një kategorie të tretë dhe fondi ka me qen nga Ministria e Kulturës. Jam shumë i lumtur që po aktivizohen këto shkollat dhe klubet të futbollit dhe ta përmbyllim infrastrukturën sportive dhe të ecim përpara me sporte.

**Isak Hoti** – E kam një përgjigje të shkurtër për znj. Fahrije Lushi sa i përket çështjes së këmbimit të pronës kjo bëhet mbi bazën e ligjit për dhënen në shfrytëzim dhe këmbim të pronës dhe bëhet vetëm në interesin e përgjithshëm. Çka do të thotë se nëse një person fizik bënë një kërkesë për këmbim të pronës, komuna nuk e jepe nëse nuk është interes i përgjithshëm, por kërkesa bëhet si në këtë raste nga kuvendi i komunës së Rahovecit, pra kjo vlen edhe për shpronësimin e pronave dhe këmbimin e pronave. Pra ligji e përcakton qartë kjo çështje mundet të mbyllët dhe të kontestohet vetëm tek çështja e kompensimit, pra nëse nuk pajtohet me vlerën që e ka përcaktuar komisioni që është përcaktuar nga Ministria e Financave.

**Fehmi Cena** - Personalisht e pëlqej këtë iniciativë sepse është shumë e nevojshme dhe është mirë që kudo që të ndërtohen fushat sportive të jenë sa më të gjëra, për që të jetë sa më legitime kjo u përmend edhe nga parafolësit dhe nënkyetari i komunës, fshati, kryesia e fshatit dhe këshillit i fshatit duhet që të jetë në dijeni, kishte me qen mirë që së paku të kemi pëlqimin e këshillit të fshatit me shkrim në kuadër të këtij dokumentacioni.

**Kryesuesi** – E qes në votim Propozim Vendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme në fshatin Ratkoc: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

#### 4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për Drejtorin për Punë Inspektuese.

**Besnik Hoti** - Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, në mungesë të shefit të auditimit të brendshëm do ju paraqes në pika të shkurta raportin e auditimi të brendshëm për punën inspektuese, ky është një raporte i cili përfshinë periudhën gjashtë mujore të periudhës së dytë të vitit 2017 dhe 2 mujorin e parë të vitit 2018. Rekomandimet të cilat kanë dalë nga auditori mbetet që ne të i zbatojmë ato, besoj se e keni lexuar materialin që ju kemi dërguar prandaj pres nga ju vërejtjet dhe sugjerimet e juaja të cilat do ti trajtojmë me seriozitetin më të madh në vitet në vazhdim.

**Rasim Fazliu** – E kam thanë edhe për raportet e tjera të auditimit që na janë sjellë, auditimi i brendshëm bëhet vetëm për një qëllim, që gabimet e legislaturës së kaluar ose vitit të kaluar qeverisës të përmirësohen. Mendoj se raportet që na vinë por edhe nëse na sillen të tjera raporte është vetëm çështje humbje kohe sepse nuk kanë kurfarë vlere, këtu shohim disa rekomandime kurse neve tanë na mungojnë veprimet e menagjmentit të kaluar dhe ne nuk e dimë se çka është bërë me këto rekomandime, sa janë mare në shqyrtim këto rekomandime dhe nëse po deri ku kanë arritur etj. mendoj se shumë ma frytdhënëse do të ishte nëse do ta kishim raportin e parë të punës 3 mujore të këtij viti se sa të merremi me vitet e kaluara sepse ne asgjë nuk mundemi të ndikojmë tanë. Shpresoj se qeveria aktuale do të jetë e përgjegjshme dhe do na sjellë raportet e auditimit të brendshëm brenda këtij mandat, në mënyrë që ne të mundemi me dhënë kontributet.

**Florije Boshnjaku** – Qysh në fillim para se të miratohet rendi i ditës kërkova që të mos votohet kjo pikë, pikërisht sepse në këtë raport në faqe nr.5 ceket: Fushëveprimi i këtij auditimi është i përqendruar në grumbullimin e të hyrave vetanake nga ngarkesat, kompensimet dhe taksat që shërbejnë për punën inspektuese për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2017 dhe për dy mujorin e parë të vitit 2018, prandaj nuk e kam të qartë dhe kjo ka qen arsyja pse kam këruar që të shtyhet në mënyrë që të jetë prezent auditori i brendshëm që të na tregoj pak më shumë rrëth këtij raporti.

**Dervish Çadraku** - Ne kemi pasur edhe materiale të auditimit të mëparshme, mendoj se këto auditime ma shumë do i shërbën ekzekutivit që ti i sheh ato gabime ose të mira që i kanë ndodhur dhe pastaj do ti keni pikat referuese se ka duhet që të veprohet, për neve kuvendarë këto janë të tejkaluara dhe nuk na hynë fare në punë dhe as që kemi ndërmend ne që të merremi me auditime. Pastaj këto rekomandime janë duke u përsëritur në të gjitha raportet e tjera dhe janë përafërsisht shumë të ngjashme, pastaj mendoj se nuk do të ishte mirë që viti 2017 të jetë në një raport me vitin 2018 sepse do të përzihen kompetencat dhe përgjegjësit, nëse ne kemi dashur të dimë se çka ka ndodhur në vitin 2017, kurse përgjegjëse është qeverisja tjetër, kurse 2 mujori i vitit aktual i paraqitur në të njëjtin raport e eliminon përgjegjësin e qeverisjes së kaluar, prandaj mendoj se nuk është dashur të jetë në një raport.

**Fehmi Cena** - Mendoj se në këtë raport auditorët kanë paraqitur mjaftë të gjetura të parregullta, po ashtu ata i kanë përcaktuar edhe rekomandimet të cilat duhet të ndermirë për tejkalimin e këtyre të gjatuarve, por vetëm se duhet që tanë drejtoria përkatëse të mirët me realizimin e këtyre rekomandimeve në mënyrë që të mos kemi

këto të pagjetura, siç e dimë inspektorati ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e inkasimit të të hyrave në komunën tonë. Po ashtu pajtohem me z. Dervish Çadrakun se është dashur të ndahen raportet e jo të përfshihet edhe viti 2017 edhe viti 2018 në një raport dhe aq më tepër kur viti i kaluar i ka takuar një qeverie tjeter. Kërkoi nga Drejtoria e inspektoratit që ta merë në përgjegjësi të plotë në duart e veta.

**Kryesuesi** - Nëse nuk ka askush të shtoj diçka sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, kalojmë në pikën e radhës:

### 5. Informatë rrith sigurisë në shkollat e Komunës së Rahovecit.

**Avni Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kam përgatitur një informatë për sigurinë në shkollat e komunës së Rahovecit, pasi të ju lexojë mundeni të parashtroni pyetje rrith kësaj informate. Që nga fillimi kur unë jam emëruar në detyrën e drejtorit të Drejtorisë Komunale për Arsim, jam përkushtuar që punët në këtë sektor mjaft të rëndësishëm të fillojnë të ecin mbarë. Fillimisht, kam mbajtur takimin e parë me drejtorët e të gjitha shkollave dhe gjëja e parë që kam kërkuar nga ta është respektimi i orarit të punës, në radhë të parë nga drejtorët e shkollave, e pastaj edhe nga mësimdhënësit dhe edukatorët. Pastaj, përtu siguruar për gjendjen fizike dhe infrastrukturore të shkollave, në një interval kohe prej më pak se 3 javësh kam vizituar të gjitha shkollat e komunës sonë. Gjatë kësaj periudhe prej 4 muajve kemi organizuar aktivitete të ndryshme me nxënës e mësimdhënës, siç ishin manifestimet kulturore dhe artistike për festën e 10 vjetorit të pavarësisë së Kosovës, konkurset letrare, garat në lëndën e Historisë, garat në Fizikë dhe në shkencat tjera të natyrës, garat në prozë e poezi, garat në recitim, manifestimet për 7 Marsin - Ditën e Mësuesit, Manifestime për Ditën e Librit, Manifestimet për Ditën e Tokës dhe aktivitete të tjera të shumta. Me një fjalë, gjatë këtyre 4 muajve kemi pasur një varg aktivitetesh, në të cilat nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave tona ishin me një pjesëmarrje mjaft të madhe dhe ishin pjesë e aktivizimit qytetar. Përveç këtyre aktiviteteve, ne kemi organizuar e mbajtur edhe debate të hapura me nxënësit, mësimdhënësit prindërit dhe shoqërinë civile! Nga këto debate mund të themi se është shtuar vullneti shoqëror për të bërë ndryshime pozitive të gjendjes së sistemit arsimor në komunën tonë! Siguria në shkolla është një çështje e rëndësishme që duhet trajtuar. Kjo çështje është e lidhur ngushtë me vijueshmërinë e nxënësve në shkolla. Nxënësit tanë, e sidomos ata të klasave të larta dhe të shkollave të mesme të larta, në qoftë se nuk vijojnë mësimin rregullisht janë të eksposuar ndaj dukurive negative me të cilat mund të përballen jashtë hapësirave shkollore. Në shkollat fillore dhe të mesme të komunës sonë, sipas shënimave më të fundit që disponojmë kemi 10625 nxënës. Në fund të gjysmë vjetorit të parë të këtij viti shkollor, nga statistika e mungesave kemi nxjerrë këto të dhëna: Në ciklin e ulët të arsimit fillor, klasat I – V, numri i përgjithshëm i mungesave është 20720. Në ciklin e lartë të arsimit fillor, klasat VI-IX, numri i përgjithshëm i mungesave është 28796, edhe pse numri i nxënësve është më i vogël se sa në ciklin e ulët. Në Shkollat e Mesme të Larta, klasat X-XII, numri i përgjithshëm i mungesave është 64360 mungesa, numër ky që është gati trefish më i madh sesa në ciklin e lartë të arsimit fillor, e që në mesatare i bie që secili nxënës për një gjysmë vjetor ka bërë 28 mungesa të arsyeshme dhe të pa arsyeshme. Nga këto të dhëna, është vënë re se vijueshmëria e nxënësve, sidomos në klasat e larta dhe në Shkollat e Mesme të Larta është nën çdo nivel. Për këtë arsy, DKA ka filluar të marrë masat e duhura administrative, duke u bazuar edhe në rregulloret dhe udhëzimet administrative. Kemi formuar një komision të veçantë për verifikimin dhe evidentimin e mungesave të nxënësve dhe mësimdhënësve nëpër 3 SHML – të dhe në SHMLP. Komisioni ka kryer punën për të cilën është ngarkuar dhe ka hartuar një raport detal të vijueshmërisë së nxënësve dhe mësimdhënësve. Pasi kemi analizuar këtë raport, kemi ndërmarrë masa për të përmirësuar gjendjen e sigurisë dhe për të rritur vijueshmërinë në procesin edukativo-arsimor. Përveç këtyre veprimeve, ne kemi analizuar gjendjen e sigurisë në shkolla edhe në debatin e organizuar nga DKA, në bashkëpunim me Qendrën Rinore, me Shërbimin Policor të Kosovës, DKRS-në, me njohës të fushës së arsimit, me Këshillat e Prindërve dhe Këshillat e nxënësve. Nga ky debat dhe nga angazhimet e drejtpërdrejta me drejtuesit e shkollave, ne kemi nxjerrë disa rekomandime për të përmirësuar gjendjen e sigurisë në shkolla. Këto janë: Të shtohet prezanca e policisë në rrugët pranë objekteve shkollore, sidomos në kohën e drekës dhe në mbrëmje, kur mbaron ndërrimi i paradites, respektivisht i pasdites; Të shtohet kontrolli i inspektoratit dhe policisë në lokalet hoteliere pranë shkollave; Të shqyrtohet mundësia e angazhimit të sigurimit privat dhe vendosja e kamerave në shkolla; Të rritet komunikimi ndërmjet mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve; Të rritet performanca e mësimdhënësve në mësim; Angazhimi i pedagogëve dhe psikologëve në shkolla; Organizimi i debateve dhe ofrimi i ndihmës/këshillave nxënësve që kanë nevojë;

Përmirësimi i infrastrukturës shkollore (banka, karrige, mjete konkretizimi); Organizimi i aktiviteteve jashtëshkollore për edukimin e të rinjve/socializimi Eliminimi i konsumimit të duhanit, alkoolit dhe eventualisht substancave narkotike në hapësirat shkollore; Kodi i veshjes në shkolla (të vlefje për nxënës dhe mësimdhënës) Takime të rregullta (obliguese) të këshillit të shkollave, këshillit të prindërve dhe nxënësve; Të rritet niveli i higjenës në shkolla; Mospërdorimi i telefonave gjatë kohës së mësimit (të vlefje për nxënës dhe mësimdhënës); Angazhimi periodik i ekspertëve të jashtëm. Me zbatimin e këtyre rekondimeve dhe me harmonizimin e tyre me udhëzimet administrative të hartuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, synojmë që të përmirësojmë jo vetëm gjendjen e sigurisë në shkolla, por edhe të risim cilësinë e arsimit në komunën tonë. Për t'i arritur këto synime, nevojitet një angazhim, përkushtim dhe koordinim i gjithmbarshëm i të gjithë neve.

**Florida Bajraktari** – Falënderoj drejtorin që na ka sjellë këtë informatë, por e kisha lutë drejtorin e DKA-së që të i kërkojë mësimdhënësve të shkollave që të kenë më shumë komunikim me prindër – mësimdhënës, në mënyrë që prindërit sa më shumë të informohen për sjelljet e fëmijëve të tyre. Kemi shumë raste kur nxënësit vetëm e gjuajnë çantën në klasë dhe fare nuk mbajnë mësim.

**Fehmi Cena** – E përgëzoj drejtorin e DKA-së që na ka sjellë këtë informatë rrëth gjendjes të shkollave të komunë sonë, ne pak a shumë i dimë sepse jemi qytetarë të kësaj komune dhe po ashtu i kemi fëmijët tanë në këto shkolla. Në këtë informatë bie në sy numri i madhe i mungesave, por ne e kemi ditur këtë sepse të bije në sy numri shumë i madh i nxënësve të cilët shëtisin nëpër rrugë dhe kafiteri gjatë orarit të mësimit. Kishte me qen mirë i drejtor që ta bëni një krahësim me komunat fqinje dhe të shihet se si qëndron puna tek ata numri i mungesave, të shihet a jemi ne të veçantë apo është një dukuri në nivel të Kosovës. Tek rekondimi i dytë angazhimi i pedagogëve dhe psikologëve nëpër shkolla, sa e di unë nuk ka pedagog dhe psikolog është vetëm rekondim i juaji. Të gjitha pikat e rekondituara janë shumë të qëlluara por unë do i veçoja këto: Eliminimi i duhanit, alkoolit, substancat narkotike, këto janë shumë me rëndësi, por si keni menduar të i eliminoni këto. Pastaj mospërdorimi i telefonit gjatë orarit të mësimit, për këtë mendoj se tek nxënësit duhet më tepër të përqendroheni sepse mësimdhënësit janë më të vetëdijshëm, në vendet e perëndimit është ndaluar dhe nuk lejohet që nxënësit të kenë telefona në klasa, me të vërtet duhet që të mëremi me këtë sepse mendoj se njëri nga shkaqet që mungon suksesi është pikërisht përdorimi i telefonave me shumicë nga nxënësit.

**Fahrije Lushi Morina** – I nderuari drejtor i keni përmendor të gjitha pikat ose dukurit të cilat besoj se do të vendosni një pasqyrë më të arsyeshme, duke nisur nga numri i madhe i mungesave të nxënësve ku sjellë një imazh krejt ndryshe, jo që nuk më ka bërë përshtypje ndonjë nga rekondimet, por mendoj se cilësia në arsim ritet atëherë kur ky numër i mungesave do të jetë më i arsyeshëm. Rekondimet lidhen me të gjitha dukuritë që i duhen shkollave, por sa janë duke u ndërmarrë këto rekondime, kërkoi që në mbledhjen e ardhshme të sillen edhe disa argumente shtesë që të përputhen me rekondimet që i keni sjellë.

**Florije Boshnjaku** – E falënderoj drejtorin që na ka sjellë këtë informatë sepse këto janë shqetësimet e gjithë neve sepse edhe ne jemi qytetarë të Kosovës dhe Komunës, por mendoj se numri i madh i mungesave nga nxënësit është për shkak të mungesës së pedagogut dhe psikologut në shkolla, nuk mundet profesori të mirët me një nxënës pse është duke munguar irregullisht. Sikur ta kishin pedagogun sikurse më parë që e kemi pasur ne mendoj se nuk do të vije deri ky numër i mungesave, shpresojmë që ky rekondim të aprovohet dhe besoj se do të zvogëlohet shumë numri i mungesave dhe do të ndryshoj qasja e nxënësve. Po ashtu e përgëzoj drejtorin e DKA-së funksionimin e këshillit të prindërve dhe shpresojmë se do të funksionoj trekëndëshi mësimdhënës – nënës – prind, besoj se të gjithë së bashku mundemi ta ndryshojmë gjendjen në arsim.

**Rasim Fazliu** – Fillimisht e falënderoj drejtorin për këtë informatë që na ka sjellë për gjendjen e sigurisë në shkolla tonë, me të vërtet është shqetësuese numri i madh i mungesave dhe ky numër i madhe i mungesave ndikon drejtpërsëdrejti në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Është mirë që përmes DKA-së, drejtorëve të shkollave dhe përmes mësimdhënësve dhe prindërve, siç e përmendi edhe znj. Florije që duhet të funksionoj trekëndëshi mësimdhënës – nxënës – prind, sa më funksional që është ky trekëndësh ne do të kemi më pak probleme si me mungesa ashtu edhe me sjellje. Në këtë informatë drejtori e ka cek se kanë ndërmarrë masa për gjendjen e sigurisë dhe për të rritur vijueshmërinë në proceset edukativo arsimore, kjo është shumë në rregull, por kishte me qen mirë që të cekën konkretisht se cilat janë ato masa që janë ndërmarrë. Edhe në legjislaturat e tjera e kam ngritë çështjen se në shkollat tonë, është mirë që të ketë edhe pedagog, psikolog edhe mjekë, por të gjithë e dimë se mundësítë buxhetore nuk janë dhe numri i punëtorëve është i kufizuar, ne

të gjithë këtu që jemi besoj se jemi pro një arsim cilësor. Propozimi imë do të ishte që të shikohen mundësit buxhetore dhe nuk është e thënë që në të gjitha shkollat të kemi pedagog dhe psikolog, por të punësohen në disa shkolla dhe ata ta kryejnë punën me rotacion, pra çdo ditë të shkojnë nëpër shkollat e ndryshme ose në ato shkolla ku shfaqen dukurit negative ata të janë prezent për të kryer punën e tyre. Desha të them edhe diçka pasi vij nga arsimi, ne fatkeqësisht kemi nxënës me nevoja të veçanta, e di që e kanë paraparë që këta nxënës është mirë të socializohen dhe të rinë me nxënësit e tjera, flasë nga përvoja ne ndoshta mundohemi që ti ndihmojmë një nxënësi me astësi të veçanta, por nëse klasa i ka 30 nxënës 29 nxënës të tjera vuajnë për arsyen se mësuesi duhet që të mirët më shumë me të, kurse tek pjesa tjetër nuk ka mundësi të jepe shumë kontribut që ta rihet diçka më shumë. Është mirë që në gjithë komunën të ketë klasa të veçanta në mënyrë që mos të pësojnë nxënësit e tjera, gjithmonë flas për qëllime të mira.

**Dervish Çadruku** – Faleminderit drejtor për këto informata të mira që na keni dhënë në kuptimin e informimit, e di që ju nuk jeni fajtor për kaq shumë dobësi që ka arsimi jonë sepse ju keni ardhur tanë në krye të DKA-së. Po është shumë e dhimbshme sepse cikli i ulët i ka diku 10623 nxënës dhe nëse i mbledhim mungesat e të gjithë këtyre na dalin 49516 mungesa dhe nëse i pjesëtojmë për secilin nxënës na dele përmbi 4 mungesa një nxënës dhe prapë nëse këto i pjesëtojmë na dalin se diku 375 muaj i kemi humbur ne nëse i llogarisim nga 22 ditë. Kjo është një humbe shumë e madhe e arsimit, dhe kjo dukuri nuk është vetëm në komunën tonë por në nivel Kosove ku është bërë një degradim i arsimit, pa dashur ti ceku se kush janë fajtor sepse ne është mirë që të merremi me punët tona. Të ju them të drejtën më pëlqyen rekomandimet e juaja nëse mundët të implementohen dhe nëse po besoj se do të kishin ndikuar mirë, çështja më e rëndësishme në arsim është komunikimi në mes prindërvë dhe mësimdhënësve, kishte me qen mirë që secili mësimdhënës të i ketë numrat e secilit prindërvë dhe komunikimi të jetë shumë më i shpeshtë, në mënyrë që prindërit të janë të informuar për aq sa është e nevojshme dhe të dinë se çka bënë fëmijët e tij në shkollë. Po ashtu është mirë që mësimdhënësit të i tregojnë nxënësve të drejtat dhe obligimet e tyre, këtu kemi ne ngecje sepse fëmijët nuk merën me obligimet që i kanë ndaj shoqërisë dhe ndaj personelit arsimor. Mendoj se është mirë që të ketë pedagog dhe psikolog në shkolla, kishte me qen mirë që të gjendet mënyra se si të vijnë deri tek ta dhe me i inkuadrua sepse kanë një rol të rëndësishëm në shkollë. Nuk e kuptova këtu se çka keni dashur të thoni me kodin e veshjeve, a ka të bëjë me uniforma apo me mënyrën e veshjeve që bëjnë nxënësit dhe arsimtarët, mendoj se duhet të ketë uniforma, po ashtu duhet të ketë kamera sepse kur ka kamera kemi dëshmi edhe për prindërit rrëth faktave. Pastaj kemi diku 64360 mungesa në shkollat e mesme nëse i pjesëtojmë me numrin e nxënësve na dalin diku 28 mungesa të arsyeshme dhe të paarsyeshme për secilin nxënës, mundeni të merrni me mend se sa mbahet procesi mësimor, pyetje ime është a ka pasur sanksione për këta nxënës me mungesa të shumta, pastaj mbajtja e telefonave me vete nga nxënësit e shkollave fillore është e meta më e madhe që e ka arsimi. Po ashtu për mua ka shumë rëndësi kontrollimi sistematik i nxënësve, dua ta di kur ka ndodhur në shkollat e komunës sonë.

**Avni Morina** – Paraprakisht ju falënderoj të gjithëve për kontributin, për sugjerimet dhe pyetjet e parashtruara. Fillimisht puna ime si drejtor i DKA-së nga 22.12.2018, i ka dy anë njëra është pozitive kurse tjetra anë është negative, ana pozitive është se unë jam punëtor i arsimit ku punoj që 19 vite dhe pak a shumë mendoj se i njoh problemet që janë në arsim, pastaj ana negative është se unë kam filluar punën në mes të vitit mësimor me disa probleme të trashëguara. Do të ndalem tek pyetja e parë që më është bërë sa i përket këshillit të nxënësve, kur e kam mare unë detyrën në fillim shumica e shkollave nuk kanë pasur fare këshillin e nxënësve por edhe ata që i kanë pasur nuk kanë qen funksional, në mbledhjen e parë që e kam bërë me drejtorët e shkollave kam kërkuar që të formohen këshillat e nxënësve, prindërvë dhe shkollave, në bazë të raporteve që kam mare nga drejtorët e shkollave në shumicën e shkollave tanë këshillat e lartë cekura janë funksional, po ashtu është bërë edhe zgjedhja e kryetarit të prindërvëve në nivel komunal. Pyetja e radhës ishte të bëjmë krahasime me komunat e tjera, të ju them të drejtën krahasime me komunat e tjera nuk më pëlqen të bëjë sepse mua më intereson se si e kemi gjendjen në komunën tonë, krahasime mundë të bëjë dikush tjetër të cilit i interesojnë statistikat. Pastaj pyetje që është bërë që është edhe në kuadër të rekomandimeve, shërbimi i psikologëve dhe pedagogëve, ju njoftoj se ne kemi bërë një kërkësë drejtar Ministerisë së Arsimit, ku kemi kërkuar që të zgjerohet stafi i arsimit me 3-4 pedagog dhe psikolog, ku këta pedagog dhe psikolog do ti angazhojmë nëpër shkolla. Të gjitha këto rekomandime që i kemi përmendur në këtë informatë kanë dalë si rezultat i debateve që ne i kemi organizuar edhe me shoqërinë civile edhe me njohësit e fushës së arsimit, për

edhe me debate që kemi pasur me nxënës, mësimdhënës dhe prindër. Pjetje e radhës ishte a keni mare ndonjë masë, e vërtet është se në fillim të janarit unë i kam gjetur nxënësit të cilat kanë bërë minimum nga 70 mungesa dhe maksimum deri në 200 mungesa të pa arsyeshme dhe nuk është ndërmarrë kurrfarë masa, kurse me rregullore e kemi të cekur se masat fillojnë të zbatohen që kur nxënësi i bënë 15 mungesa pa arsyen. Po ashtu në një nga shkollat janë falur të gjitha mungesat e muajit shtator të pa arsyeshme janë bërë të arsyeshme, kjo ka qen një shkelje, ne problemet më të mëdha i kemi me shkollat e mesme, numri i mungesave të shkollave të mesme edhe pse numri i nxënësve është shumë më i vogël se sa në shkollat fillore, por numri i mungesave është 3 fish më i madh se sa në shkollat fillore, masat kanë filluar të merren pasi ata i kanë kaluar të gjitha kufijtë si transferimet nga një shkollë në shkollën tjeter, ku Krusha dhe Ratkoci filloj të ankohet pse na kanë ardhur shumë nxënës nga Rahoveci dhe anasjelltas filluan të ankohen në Rahovec pse na kanë ardhur shumë nxënës nga Ratkoci dhe Krusha e kështu me radhë, ne nuk kemi se ku të i dërgojmë duhet brenda për brenda sistemit të komunës sonë. Tek kodi i veshjes me qëllim nuk e kemi cekur për uniformë, nëse flasim përkodin e veshjes nuk do të thotë se gjithsesi të jetë uniforma, nëse e doni mendimin time personalisht unë nuk jam që të ketë uniforma, por jam për atë që nxënësit të na vinë të veshur në shkollat tona e jo të na vijnë gjysmë të zhveshur sikurse që po na ndodhë, nëse kjo çështje lidhet me aspektin e sigurisë në shkolla atëherë normalisht duhet të ketë ndoshta uniforma në mënyrë që nxënësit të identifikohen që janë nga ajo shkollë. Për të funksionuar trekëndëshi mësimdhënës – nxënës – prindër, ne duhet që të punojmë të gjithë së bashku,, këto këshilla që janë tanë të themeluara të jenë funksionale dhe të punojnë, unë kam kërkuar nga drejtoret veçanërisht këshillat e prindërvë të mos emërohen por të zgjidhen. Mendoj se ky funksionim do të ishte normal nëse këto këshilla do të jenë legjitime, e jo të zgjidhet përfaqësues i këshillit të prindërvë të një shkolle i emëruar nga rruga drejtori i shkollës, vetëm pse ka muhabet me te, këso zgjedhje nuk kanë qenë të radha në shkollat e komunës sonë. Sa i përket kontrollimit sistematik mjekësor në shkolla mendoj se është më shumë përgjegjësi e drejtorisë së shëndetësisë dhe në këtë pjesë nuk mundem të japë unë ndonjë përgjigje, por ajo çka mundem të them unë është se ne do të jemi në bashkëpunim me të gjitha drejtorit e komunës që sa herë ata të kenë programe për shkolla unë do i ofroj përkrahje. Pastaj se i përket pyetjes për klasat speciale, në komunën tonë janë disa klasa speciale ose si quhen ndryshe kasat e bashkangjitura, por mua më shqetëson fakti se pikërisht mos përkushtimi i mjaftueshmë i drejtoreve të shkollave dhe mësimdhënësve, por edhe të prindërvë, këto raste ndoshta edhe nuk janë evidentuar aq sa duhet, nuk e mohoj faktin se mundet të ketë nëpër shkolla dhe klasa të ndryshme në mesin e 30 nxënësve dhe në mesin e tyre njëri mundet të jetë me aftësi të kufizuar ose me ndonjë lloj sëmundje tjeter që nuk janë evidentuar dhe ka shkuar kështu siç ka shkuar.

**Florije Boshnjaku** – Tek fëmijët me nevoja të veçanta për klasat e bashkangjitura është shqetësim i të gjithëve, por kisha kërkuar nga ju që Asociacion të Komunave të Kosovës ta ngritni këtë çështje sepse për me i than dikujt se ky fëmijë është me nevoja të veçanta duhet që të ngritet një komision i profesionistëve dhe ata besoj se e caktojnë se ku duhet të shkojë ky fëmijë, në klasa normale apo në klasa të bashkangjitura.

**Kryesuesi** – Nëse nuk ka askush të shtoj diçka më shumë sa i përket kësaj pika kalojmë në pikën e radhës:

#### 6. Informatë rreth ecurisë së hartimit të PZHK-së.

**Rumir Zhuniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ju paraqes një informatë rreth ecurisë së PZHK-së, Kuvendi Komunal i Rahovecit me datë 31 janar 2017, ka mare një vendim për hartimin e planit të ri zhvillimor komunal si dhe ka hartuar programin për hartimin e këtij plani, mbi bazën e këtij vendimi është shpallur tenderi nga komuna e Rahovecit dhe është nënshkruar kontrata me studion e arkitekturës dhe planifikimit hapësinorë Prima Ingjering nga Prishtina në mbështetje të komunës së Rahovecit, për hartimin e planit zhvillimor komunal, bartëse e kësaj kontrate është Drejtoria për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtjet të mjesdit si organ përgjegjës për planifikim në komunën e Rahovecit. Me datë 27 janar 2018 Kryetari i Komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi me vendim ka formuar komitetin drejtues për hartimin e planit zhvillimor komunal, në përbërje të të gjitha drejtoreve të drejtoreve komunale si dhe stafit të drejtorisë së urbanizmit, planifikimit dhe mbrojtjes së mjesdit. Koordinator i Komitetit drejtues për hartimin e PZHK-së është caktuar nën kryetari i komunës z. Fatmir Iska, me datë 29 mars 2018 komiteti drejtues ka mbajtur takimin e parë ku është kërkuar nga të gjithë drejtoret e drejtoreve sektoriale, që ti mbledhin të gjitha të dhënat ekzistuese të drejtoreve që udhëheqin dhe ti dërgojnë në drejtori për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjesdit si përgjegjëse për projektin e hartimit të planit zhvillimor komunal. Tani jemi në fazën e mbledhje të dhënavë ekzistuese ku do të vazhdojmë sipas planit të paraparë.

**Rasim Fazliu** – Ne Komuna e Rahovecit e kemi pas PZHK-në, ku kemi diskutuar dhe debatuar, kemi dhënë edhe mjete për këtë plan, por në fund kemi qen shumë të pakënaqur, po ju citoj ish kryesuesin e Kuvendit z. Nahit Elshani i cili i patë thënë hartuesit të PZHK-së, po ju citoj: Që ishte nga Prishtina, i nderuar bash hiq kurrgjë nuk paske bërë, të gjitha i qenkan bërë Kopi paste. Ne jemi për një PZHK të mirëfilltë dhe të japid të gjithë kontributin, më vije mirë që qenka formuar Komiteti punës, në fund do të keni edhe kontributin e KPF edhe të Kuvendit, kishte me qen mirë që të shfrytëzoni edhe ekspertë të tjera që janë jashtë Komunës në mënyrë që të kemi një PZHK të mirëfilltë dhe ashtu si duhet. E them ketë sepse e kemi një përvojë të keqe me atë që ka ndodhur me planin e kaluar, por besoj se tani kemi mbledhur mend dhe duke i bashkuar forcat do ta bëjmë një plan ashtu siç i ka hipe një Komune.

**Florije Boshnjaku** – Siç e ceku edhe kolegu ne kemi pasur edhe më herët PZHK-në, me vite ka zgjatur dhe prapë nuk kemi mundur me ardhë në përfundim, por besoj dhe shpresoj se tani PZHK-ja do të merë kaheje ashtu siç i ka hipe një Komune të ketë një PZHK. Është mirë që ky plan kur të dele në diskutim,, propozimi imë është që të ftohen ekspertët nga Komune e Rahovecit të cilët e njohin Komunën se ku duhet të shkoj Komuna e Rahovecit, të ftohen edhe këshillat e fshatrave që secili kryetar i fshatit, mjekët pra të përfshihen të gjithë lëmit të japid një kontribut, në mënyrë që PZHK-ja të gjejë zbatim sepse ne e kemi një përvojë jo të mirë me këto plane.

**Kryesuesi** – Nëse nuk ka askush të shtoj diçka sa i përket kësaj pike kalojmë në pikën e radhës:

#### 7. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Stone Castle).

**Isak Hoti** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kjo rrjedhë në bazën e një kërkese të kompanisë Stone Castle, drejtuar Drejtorisë për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, fjala është për zonën kadastrale 231/7 në bërnjak me kulturë arë e klasit të parë me një sipërfaqe prej 97 ari. Është përmendur pak më herët PZHK-ja, në pikën 3 të propozim vendimit e kemi cekur se kjo zonë nuk është e planifikuar në PZHK, si rezultat i kësaj ligji për tokat bujqësore neni 44 pika 4.1 thotë: Deri në nxjerrjen e planit hapësinor, shfrytëzuesi i tokës bujqësore, për qëllime bujqësore mundet të bëhet vetëm në bazë të vendimit të kuvendit Komunal, pastaj e kemi udhëzimin administrative, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ku i ka dy kategori, e ato janë kategoria e përkohshme dhe e përhershme, për shkak se kërkesa e palës është që të ndërtohet një hotel rezidencial me përmasa më të mëdha ndoshta në tërë Kosovën, kërkesa e palës është që të bëhet e përhershme. Tek neni 6 te kompetencat për marrje të vendimit ceket: Nderim destinimi i përhershëm i tokës bujqësore në klasën 1-4 do të bëhet me vendim të Kuvendit Komunal. Edhe me udhëzimi administrativ 041/2006 për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ky vendim një herë do të shkojë në MBPZHRR, pastaj ata vodosin me një komision të posaçëm që e kanë për ndërrim destinimit të pronave ku do të dalin në vendin e ngjarjes dhe pastaj kjo është kompetencë e MBPZHRR. Kostoja për ndërrim dhe destinim të tokës është goxha e lartë por ai ka pranuar, dhe në bazë të nenit 14 të udhëzimit administrativ nga klasa 1-4 kompensohet deri në 1.00 për  $m^2$ . Kërkoi falje që ka ardhir pak me vonesë materiali i kësaj pike por është dashur që të konsultohemi mirë me ligjin. Një ndër pikat kryesore e thotë se nuk duhet të jetë në perimetrin e sistemit të ujitjes, e kam një shkresë me nr. Protokolli 335 të datës 15.05.2018, që është lëshuar nga kompania e Radoniqit dhe aty e precizon se kjo pjesë është jashtë perimetrit të sistemin e ujitjes.

**Rasim Fazliu** - Meqenëse ne nuk e kemi pas materialin me kohë, propozoj që mos të humbim kohë ta kalojmë sot kështu për në mbledhje të Kuvendit, pastaj në mbledhje të kuvendit do e diskutojmë sepse kemi kohë për ta lexuar materialin.

**Nënkryetari** – Ne të gjithë e kuptojmë zhvillimin e turizmit, investimin sepse është një investim mbi 6 milion, ne jemi takuar disa herë me pronarin dhe me rendësi punën që ka me e bë është në pronën e vetë. Plani Zhvillimor Komunal që e diskutuan më parë, zona kadastrale e Bërnjakës dhe Dobidolit nuk është e përfshirë në PZHK e vjetër, kurse në PZHK-në e re tani duhet që të përfshihet, ne jemi takuar edhe me përfaqësuesin e Stone Castle ku jemi siguruar që në seancën e Kuvendit do të jetë edhe ai i pranishëm, ku do ta elaboroj në detaje projektin se çka do të bëjë sepse është një investim goxha i madh.

**Florije Boshnjaku** – Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës edhe unë jam e pajtimit që duhet të kalojë në kuvend, mendoj se është interes i përgjithshëm, sepse do të ketë edhe punësim po ashtu më vije mirë që është afërt Fortesës, neve na mbetet vetëm ta japid pëlqimin pasi nuk qenka i përfshirë në PZHK-në e vjetër.

**Dervish Çadraku** – Ne tanë jemi duke biseduar për çendjen aktuale, pra nuk është në kuadër të një plani zhvillimor, por në besojmë se do të dele PZHK-ja dhe ta përfshi edhe atë sipërsaqe, e thash në fillim të mbledhjes së kjo pikë duhet të shtyhet sepse ne duhet që të marrim edhe informata shtesë për këtë projekt. Siç e dini M Silosi i ka pasur 340 punëtor me spinof special, kurse tanë nuk i ka as 40 punëtor, propozoj që ko pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen tjetër, ne tanë e kemi materialin dhe do e lexojmë e pastaj vendosim.

**Fehmi Cena** – Ne nuk kemi çka të shtojmë më shumë, por vërejtja jonë është se nuk e kemi materialin me kohë që ta analizojmë pak më hollësish, përndryshe nuk kemi asgjë kundër këtij propozimi. Kishte me qen mirë që kur të vije në mbledhje pronari i Stone Castle të ketë një skicë dhe të na tregoj pak më në detaje, pastaj ne do të vendosim a do ta aprovojmë apo jo.

**Nënkyetari** – Ne realisht pajtohem i mendimin e juaj, e përmendi edhe z. Isak Hoti, por edhe unë prapë po e potencoju se faji është i ynë për shpërndarje jo me kohë të materialit, por tanë e keni dhe besoj se hapësirën që e keni dëri në mbledhje të Kuvendit, mendoj se keni mjaftë kohë për ta analizuar. Pastaj janë edhe procedurat e tjera sepse nga ne kërkohet vetëm një lloje pëlqimi, kurse investitori prapë duhet që të shkojë në ministri përkatëse që të kërkojë edhe pëlqime të tjera, prapë edhe aty i merë shumë kohë dhe nëse ne e shtymë atëherë nuk munden të ja fillojnë punës deri ka muaji gusht ose shtator. Prandaj besoj se kishte me qen mirë që të vazhdohet kjo pikë për këtë mbledhje të kuvendit.

**Kryesuesi** – E qes në votim Propozim Vendimin për destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Stone Castle): Konstatoj se me 1 abstenim dhe asnjë kundër është aprovuar pika e shtatë (7). Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

#### **8. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale.**

**Afrim Oruqi** – Të nderuar kuvendarë para juve keni 4 propozim vendime të cilat kanë bëjnë me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale deri në 15 vite, të gjitha këto bëhen në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale, ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës publike dhe në bazë të rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

**Rasim Fazliu** – I nderuari Kryesues është mirë që të shkohet në votim një nga një, po ashtu propozoj që për mbledhje të Kuvendit të janë si pika të veçanta sepse secila i ka specifikat e veta.

**Afrim Oruqi** – Vazhdojmë me propozim vendimin me Nr. 01/236/2018, propozimi ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim, ky propozim vendim ka të bëjë për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të zonës kadastrale në Nashpallë, pronë shtetërore e Komunës së Rahovecit, propozimi është që të i jepet në shfrytëzim për 15 vite. qëllimi i dhënien në shfrytëzim të kësaj parcele dhe parcelave tjera në vijim që do i prezantoj është me të vetmin fakte se këto parcella shtetërore komunale të jepen në shfrytëzim me qëllimin e vetëm që njerëzit të vetëpunësohen dhe këto prona punohen. Pastaj qëllimi tjetër është që këto prona pas 15 vite të i ritet vlera dhe në një farë forme tjetër është që ti ruajmë pronat tonë nga uzurpiimet. Ne kemi trashëguar një dokument i cili përban përafërsisht mbi 230 prona komunale të uzurpuara. Të gjitha këto prona do të jepen në përputhje me rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, në rast se marrim pëlqim nga ju dhe nga Kuvendi i Komunës, të drejtat dhe përgjegjësit si për këtë vendim ashtu edhe për propozimet e tjera që do i paraqes në vijim, kryetari i komunës e ka mare përsipër që kërkuesi i pronës duhet të deklaroj se për çka do të shfrytëzoj këtë prona, në të kundërtën nëse nuk i përbahet kontratës ndo të prishet marrëveshja ndërmjet personave fizik dhe juridik. Në rast se kalon të gjitha këto procedura do të realizohen përmes ankandit publik.

**Rasim Fazliu** – Mirë që na ka ardhur ky propozim, është cekur shumë mirë se pse është duke u dhënë ko pronë, për arsy që mos të vije deri te keqpërdorimet eventuale, por propozoj që për mbledhje të Kuvendit të ceket se prona komunale do të jepet në shfrytëzim afatshkurtër 1 - 15 vite me ankand publik, e mos të thuhet vetëm 15 vite sepse kuvendi është ai që vendos se sa do të jetë afati kohorë. Po ashtu nëse keni informata se për çka do të jepet kjo tokë kishte me qen mirë të ceket dhe ne do jemi pastaj më të përgjegjshëm edhe sa i përket kohëzgjatjes.

**Isak Hoti** – I nderuari z. Rasim Fazliu, në vendim e cekim specifisht sepse një vendim na kanë kthyer MAPL-ja sepse e cekë 1-15, pikërisht për këtë ne e kemi lënë për 15 vite, tash ju jeni ata që vendosni dhe ne kur ta përpilojmë vendimin i cili nënshkruhet dhe dërgohet për MAPL aty e cekim saktë se sa vite ju i keni caktuar si kuvendi.

**Rasim Fazliu** – Pa dashtë të polemizojë, por pikërisht pasi është propozim vendim është mirë të ceket nga 1-15 vite, pastaj në kuven vendoset se për sa vite do e jepim.

**Florije Boshnjaku** – Për afatshkurtër ceket deri në 15 vite, mendoj se qeveria komunale duhet të dele me një propozim për kuven, pastaj ne si kuven jemi ata që vendosim se a do ta përkrahim propozimin e qeverisë apo jo. Këto parcela që po na vinë për çdo ditë është për shkak të mungesës së regjistrimit të pronës së paluajtshme, nëse kishte me përfunduar regjistrimi i të gjitha pronave komunale të paluajtshme, me siguri do të ishte bërë më mirë dhe ma qartë se sa prona i ka Komuna. Jam pro këtij propozim vendimi që të kalojë për kuven.

**Isak Hoti** – E nderuara znj. Florije i kemi dy paragrafë të cilat i kemi ndarë, tek pika e parë kemi cekur decidivisht se ju jepet personave fizik dhe juridik për zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite, pra këtu nuk e kemi përcaktuar. Kurse tek pika katër propozimi i kryetarit është për 15 vite.

**Dervish Çadruku** – Pothuajse së të gjitha këto propozim vendime që i kemi para nesh këtu janë të ngjashme, dhe kanë të bëjnë me pronat e Komunës e klasit tokë, mendoj se nuk është shumë esenciale se për sa vite do të jepet kjo, por përmua ka rëndësi shumë se cili është destinacioni, mos ka destinacion përtu u ngritur objekte, prandaj është mirë që për mbledhje të kuvenit të kemi këtë informatë. Pajtohem se nëse është për bujqësi sepse këto parcela shumë shpesh uzurpojen nga qytetarë të ndryshëm dhe nëse jepen atëherë i ruhet ajo tërësia dhe nuk ka rrezik për ndonjë uzurpim. Ne kemi pas raste që na kanë ardhur investor nga jashtë kurse ne nuk kemi pasur vend dhe hapësirë që ti jepim për ngritje të ndonjë objekti profitabil. E mbaj mend kur kam qen drejtor, kanë ardhur nga Zvicra përta ngritur një objekt përpunimin e mbeturinave kurse Komuna nuk ka pasur hapësirë përtë ju dhënë.

**Kryesuesi** – I qes në votim një nga një propozim vendimet, e qes në votim propozim vendimin me Nr. 01/236/2018: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar propozimi i parë. Kalojmë tek propozimi dytë:

**Afrim Oruqi** – Propozimi me Nr. 01/237/18, është në zonë kadastrale në Çifllak zonë e quajtur Shtupika, e cila ka të bëjë me 2 hektar e jo 6 qysh është në propozim vendim, është bërë një gabim teknik do të përmirësojmë për mbledhje të kuvenit. Tani ju mbetet juve të vendosni se sa vite do i jepni. Sa i përket pyetjes se për çfarë destinimi do i jepet, këtu kemi të bëjmë me tokë të klasit 2,3,4, qëllimi i tyre është për destinim bujqësor, por për secili kryetari i Komunës do të bëjë një marrëveshja me secilin përsfitues të këtyre tokave dhe aty do të specifikohet se për çka kanë të drejtë të i shfrytëzojnë këto toka. Kërkoj nga ju që të jepni pëlqimin që kjo pikë të vazhdoj për Kuven.

**Kryesuesi** – E qes në votim propozimin me Nr. 01/237/18: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar propozimi i dytë. Kalojmë në propozimin e tretë:

**Afrim Oruqi** – Propozimi me Nr. 01/238/18, ka të bëjë në zonën kadastrale në Çifllak, zonë e njohur si Shtupika, sipërfaqja e parcelës është 4 hektar, qëllimi i këtij propozimi është i njëjtë sikurse i propozimeve të kaluar për dhënien në shfrytëzim të pronave publike. Kërkoj nga ju që të jepni pëlqimin edhe kësaj pikë që të vazhdoj për Kuven.

**Kryesuesi** – E qes në aprovim propozim vendimin me Nr. 01/238/18: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar propozimi i tretë. Kalojmë në propozimin e katërt:

**Afrim Oruqi** - Propozimi me Nr. 01/239/18, këtu kemi të bëjmë me disa parcela kadastrale, arsyeva pse janë në të njëjtin propozim vendim këto parcela është sepse janë të ngjitura njëra me tjetrën, zona kadastrale gjendet në Rahovec më saktë në Rimnik. Është kërkuar miratimi në pako i këtyre parcelave për shfrytëzim të pronës komunale në afat prej 15 viteve. Kërkoj nga ju që të jepni pëlqimin edhe kësaj pikë që të vazhdoj për Kuven.

**Kryesuesi** – E qes në aprovim propozim vendimin me Nr. 01/239/18: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar edhe propozimi i katërt. Tenë të nderuar e qes në aprovim të gjitha propozimet pra si pikë të tetë të rendit të ditës: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e tetë (8) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

**9. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për Caktimin e Lokacionit për Vendosjen e Trafostacionit dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale.**

**Përparim Krasniqi** – Këtu kemi të bëjmë me një trafo e cila është e vendosur para dyerve të një banori nga Krusha e Madhe, nga ne kërkohet që kjo trafo të zhvendoset në një pronë tjetër, ne e kemi caktuar zonën se ku


do të a vendosim këtë trafo dhe nuk do të ketë kurrfarë pengesa. Kërkoj nga ju që ta votoni këtë propozim që tē kalojë për mbledhje të kuvendit.

**Kryesuesi** – E hapim diskutimin rrëth kësaj pike, nëse nuk ka askush të shtoj diçka, e qes në votim Propozim Vendimin për Caktimin e Lokacionit për Vendosjen e Trafostacionit dhe dhëni në shfrytëzim asfatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e nëntë(9) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

**10. Të Ndyshme.**

**Kryesuesi** – A ka dikush të shtoj diçka në pikën e fundit, nëse jo atëherë të nderuar anëtar të KPF-së ju falënderoj për kontributin e dhënë sot, shihemi në takimet e radhës.

Procesmbajtësi,

  
Skender Hamza



Afrim Dina

